ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **AGJENCIONI VETERINARISË DHE USHQIMIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **40800-24-1162-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Shërbimet e repelimit të kafshëve dhe dezinsektimit të fermave për sëmundjen e Etheve Hemorragjike - Krime Kongo**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**KLER CLEAN**
NUI	**811856311**
Adresa	**Rr. Faik Konica , pn**
Vendi	**Prizren**
Kodi postar	**20000**
Numri Telefonit	**048912121**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Kushtrim Selaj**
Adresa elektronike	**klercleanshpk@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**07.05.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Shërbimet e repelimit të kafshëve dhe dezinsektimit të fermave për sëmundjen e Etheve Hemorragjike - Krime Kongo

1.Hapja e ofertave: 07.04.2024

2.Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi më i ulët i përgjegjshëm

3.Titulli: Shërbimet e repelimit të kafshëve dhe dezinsektimit të fermave për sëmundjen e Etheve Hemorragjike - Krime Kongo

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kërkesa pë rishqyrtim: 30.04.2024

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e

Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Supozohet se janë shkelur dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L- 237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.
Neni 1 - Qëllimi
Neni 7 - Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi
Neni 69 - Aftësia teknike dhe/ose Profesionale
Dispozitat e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik
Neni 25 - Kriteret e përzgjedhjes

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kompania e shërbimeve dhe furnizimeve me preparate kimike " KLER CLEAN" SHPK, pas vështrimit të kritereve të vendosura në këtë dosje të tenderit, kemi vërejtur se Autoriteti Kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë Nenin 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi) ku Qëllimi i këtij neni është që Autoriteti Kontraktues t'i trajtoj në mënyrë të barabartë operatorët ekonomik dhe jo në mënyrë diskriminuese dhe poashtu të veproj në mënyrë transparente, duke larguar kërkesat kufizuese dhe jo ligjore të vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Kërkesat nuk janë në harmoni as me legjislacionin primar e as sekondar të Ligjit për Prokurimin Publik në lidhje me operatorët e rinj ekonomik,supozohet se AK-ja ka vendosur kërkesa diskriminuese. Kërkesat nuk janë minimale për kualifikim dhe nuk janë të drejtëpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.

Sipas dosjes së tenderit Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar me kontrata të rregullta së paku pesë (5) veterinarë dhe pesë (5) teknik të veterinarisë që do të angazhohen për këtë aktivitet.
Dëshmia 2. Lista e punëtorëve të punësuar për kryerjen e këtij aktiviteti, CV-të, diplomat e kualifikimit dhe si **dëshmi duhet të paraqesin pagesat e kontributeve të tatimeve pranë ATK-së (në 12 muajt e fundit)**
Kjo kërkesë që duhet dëshmuar kontributet e pagave pran Administratës Tatimore për 12 muaj mendojmë se diskriminon operatorët e rinj ekonomik të cilët funksionojnë si biznese të vogla/individuale që punojnë me termin "3 mujorshi" të cilët nuk kanë fuqi dhe kapacitete për të arritur **qarkullimin për tu konsideruar si deklarues i kontributeve per 12 muajt e fundit**, dhe ky kriter mendoj se është diskrimunues dhe shkelje flagrante e

dispozitave të LPP-se dhe Rregullores së Prokurimit, si e till dëshmia duhet të paraqesin pagesat e kontributeve të tatimeve pranë ATK-së (në 12 muajt e fundit) duhet të hiqet pasi që kufizon konkurrencen dhe ky staf mundë të angazhohet me parakontrata ose kontrata pune duke ju bashkangjitur Diplomat dhe CV-it.

Kërkesa 4. Preparati "Repelentit" akaricidit për largimin e rriqrave nga kafshët duhet të ketë certifikatën e Marketing - Autorizimit të lëshuar nga AUV
Dëshmia 4. **Certifikatën e Marketing autorizimit të lëshuar nga AUV për preparatin** "Repelentit" akaricidit për largimin e rriqrave nga kafshët – Kopje.
Certifikat e marketingut e lëshuar nga AUV e kufizon në mënyrë direkte konkurrencën, dhe si kriter është i panevojshem pasi që nuk mund të regjistrosh produktin dhe ta importosh në Republiken e Kosoves përderisa nuk shpërblehesh me kontratë dhe mendojmë se ky kriter e përcakton fituesin e këti projekti dhe kufizon në mënyrë direkte konkurrencën dhe na pamundëson pjesmarrjen edhe si grup i operatorëve ekonomik.

Sipas Ligjit për Prokurim Publik, Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik".
Neni 25.6 i Rregullores së Prokurimit Publik thotë: "Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë"

Kërkojmë nga OSHP që pas elaborimit të të gjitha pretendimeve tona ankimore në lidhje me shkeljet e supozuara të dispozitave ligjore që janë në fuqi,
të nxjerr:
Vendim
Aprovohet si e bazuar ankesa në lidhje me aktivitetin e prokurimit
Të hiqen kriteret diskriminuse dhe lenda të kthehet të ri-vlersim

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Përveq dëmëe materiale, jemi të dëmtuar edhe moralisht pasi që jemi përfaqsues i disa brendeve botërore të preparateve kimike, biocide, rodenticide, insekticide, produkte veterinare etj.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*

c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*